



Pranuar / Doretuar Prilidjen/Prilidato Received/Delivery	19-01-2023	3	viti god year
Organ / Shista Organ / Jednica Org. Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No.	Shtesa Pulog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKQVISHCK	534/2023		116



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1033/2-22

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës me numër A.nr.1033/2022 të datës 21.11.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në Lagjen "Dardania" Nr.2/29, Gjilan, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.1033/2022 e datës 21.11.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. *Obligohet* Komisioni i Vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë, që në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të përfundoj procesin e vlerësimit lidhur me pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve*, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- III. *Obligohet* Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 21.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7255/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos publikimit të vlerësimit të rezultateve të intervistës me gojë lidhur me Konkursin për lëvizje brenda

kategorisë, për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit më datë 05.12.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat ndërlidhur me çështjen ankimore.

Me vendimin VK.nr.197/2022 të datës 27.12.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka aprovuar kërkesën për shtyrje të afatit për vendosje të ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokolli 7255/2022 të datës 21.11.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN00009710 i datës 19.08.2022; Njoftimin e datës 20.09.2022; Njoftimin e datës 19.08.2022; E-mailin nga për i datës 31.10.2022; E-mailin nga për K. S i datës 14.11.2022; Kopjen e thirrjeve të datës 21.09.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 7418/2022 e datës 25.11.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 7636/2022 e datës 05.12.2022; Urdhër për emërim për me numër reference KPS/PD/AP/4840/O i datës 19.05.2005 nga Shërbimi Policor i Kosovës; Vërtetimin e punësimit për me numër reference 04/01-06/SRR/0605/2022 i datës 31.08.2022; Vendimin për K. S me numër reference PK/DP/AP/7284 i datës 20.07.2010; Vendimin me numër reference 07/1-01A/7659 i datës 23.12.2013; Letër Rekomandimin për e datës 05.09.2022; Letër Rekomandimin për e datës 16.03.2018; Kopjen e letërnjoftimit e Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategoritë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional i datës 28.01.2022; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategoritë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional i datës 19.01.2021; Vërtetimin për me numër reference 07/1-01SAP-P/7092 i datës 01.09.2022; Aplikacionin e kandidatit i datës 12.09.2022; E-mailin nga për i datës 19.10.2022; E-mailin nga për i datës 19.10.2022; Diplomën e me numër protokolli 206 e datës 27.05.2002; Diplomën e me numër 165 e datës 04.05.2016; Diplomën e me numër 262 e datës 18.05.2011; Certifikatën për e datës 12.10-16.10.2009; Certifikatën për e datës 22.12.09 deri me 26.03.2010; Certifikatën për e datës 03.02-14.03.2014; Certifikate për e datës 14.04-22.05.2015; Certifikate për e datës 18.12.2016; Certifikatën për me numër protokolli 30/22 e datës 16-17.05.2022; Aplikacioni i i datës 7.09.2022; Diplomën e me numër 1997/18 e datës 01.11.2018; Certifikatën për me numër reference 505/0512 e datës 03.05.2012; Diplomën e me numër 060/0113 e datës 09.01.2013; Diplomën e me numër 54-P/09 e datës 17.12.2009; Diplomën e me numër 452/09 e datës 09.06.2009; Diplomën e me numër protokolli 151/602 e datës 29.05.2022; Certifikatën për e datës 16 dhe 17.03.2022; Certifikatën për e datës 20-21.09.2018; Certifikatën për për datës 18 dhe 21.09.2018; Certifikatën për e datës 26-27.04.2018; Certifikatën për e datës 28-29.03.2018; Certifikatën për e datës 28-29.09.2015; Certifikatën për e datës 2-5.2011; Certifikatën për e datës 28 dhe 29.04.2022; Certifikatën për e datës 15.09.2012; Akt Emërim për me numër 112/01-34463 i datës 10.11.2021; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit i i datës 13.09.2018; Vendimin me numër 112/02-34218 i datës 03.11.2021; Vendimin me numër 112/02-559 i datës 15.01.2018; Vërtetimin e Marrëdhënies së

Punës për me numër 112/184/2022 i datës 24.08.2022; Vërtetimin për me numër 370/14 i datës 22.07.2014; Vërtetimin për me numër 124/12 i datës 07.09.2012; Akt Emërimit e me numër 112-143/2 i datës 10.04.2015; Vendimin me numër 14/09/15 i datës 22.04.2015; Vërtetimin e Marrëdhënies së Punës për me numër 112/184/2022 i datës 24.08.2022; Letër Rekomandimin për e datës dhjetor 2014; ARBK; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i me numër 112/02-6136 i datës 23.03.2017; Vendimin me numër 14/09/15 i datës 22.04.2015; Diplomën e datës 16.03.2001; Letër Rekomandimin për datës mars 2018; Letër Rekomandimin për datës shtator 2017; Letër Rekomandimin për nga Referencën për e datës gusht 2022; Referencën për datës dhjetor 2021; Letër Rekomandimin për e datës dhjetor 2014; Letër Rekomandimi për e datës 31.05.2012; Kopjen e letërnjoftimit e Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë për Kategoritë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional për i datës 06.01.2022; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë për Kategoritë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesional për i datës 31.12.2020; Vërtetim in përi me numër 112/182/2022 i datës 24.08.2022; Certifikatën nga Gjykata për e datës 23.08.2022; Aplikacionin e i datës 09.09.2022; Diplomën pë me numër 75 e datës 05.07.2022; Vendimin me numër 5679-03 i datës 20.09.2022; Njoftimin e datës 20.09.2022; Listën e Aplikantëve me numër reference RN00009710; Njoftimin për konkursin e publikuar ne datë 19.08.2022; Vendimin për formimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë (KVLBK) me numër 5681-02 i datës 20.09.2022; Njoftimin e Kandidatëve për intervistë me gojë përmes e-mailit të datës 21.09.2022; E-mail për I nga i datës 21.09.2022; E-mail për nga i datës 21.09.2022; E-mail për nga i datës 21.09.2022; Formularin Individual gjatë Intervistimit me gojë i datës 30.09.2022; Formularin Individual gjatë Intervistimit me gojë i datës 30.09.2022; E-mail nga për i datës 10.10.2022; E-mail nga për i datës 03.10.2022; E-mail nga për i datës 06.10.2022; E-mail nga për i datës 04.10.2022; E-mail nga për i datës 01.11.2022; E-mail nga për datës 31.10.2022; E-mail nga për etj. i datës 01.11.2022; E-mail nga për i datës 01.11.2022; E-mail nga për etj. i datës 02.11.2022; E-mail nga për etj. i datës 02.11.2022; E-mail nga për etj. i datës 02.11.2022; E-mail nga për etj. i datës 01.11.2022; E-mail nga për i datës 14.11.2022; E-mail nga për i datës 01.11.2022; E-mail nga për i datës 31.10.2022; Vendimin me numër VK.nr.197/2022 i datës 27.12.2022;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se është e bazuar ankesa e ankuesit, *sepse*:

Nga administrimi i provave materiale rezulton së Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më datë 19.08.2022 ka publikuar Konkursin me numër reference RN00009710 për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve", e në të cilin konkurs ka aplikuar dhe ankuesi. Rrjedhimisht, Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 07.09.2022 deri më datë 14.09.2022 dhe së në këtë konkurs kanë aplikuar tre kandidatë, ku vetëm dy prej tyre (përshirë ankuesin) kanë plotësuar kriteret e konkursit, duke vazhduar me intervistën me gojë të mbajtur me datë 30.09.2022, e në të cilën ka marrë pjesë vetëm ankuesi.

Duke qenë së ankuesi nuk është njoftuar lidhur me rezultatin e intervistës më gojë, i njëjti më datë 31.10.2022 i është drejtuar më shkrim Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më kërkesë që të njoftohet lidhur me rezultatin e intervistës me gojë, ndërsa më datë 14.11.2022 Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore ka njoftuar ankuesin se : *kërkesa juaj është adresuar tek Kryesuesja e komisionit pasi që çështja ka mbetur tek Kryesuesja e komisionit për përfundimin e procesit.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon së mos publikimi i vlerësimit të rezultateve të intervistës më gojë lidhur me pozitën Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, është veprim në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyroj Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që të publikoj rezultatin e intervistës më gojë.

Në përgjigjen në ankesë, Njësia e Burimeve të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë thekson së anëtarët e Komisionit të Vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë sipas deklaratave të tyre kanë bërë vlerësimin e ankuesit në sistem, ndërsa kryesuesja e Komisionit të Vlerësimit nuk ka bërë vlerësimin me arsyetimin së e njëjta nuk ka pas njohuri lidhur me procesin e vlerësimit, andaj pa këtë vlerësim nuk mund të vazhdohet me tej kjo procedurë.

Sipas Konkursit më numër reference RN00009710 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës *“Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve”*, si kushte për lëvizjen brenda kategorisë janë përcaktuar: *Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit’*. Ndërsa si kërkesat e përgjithshme formale janë vendosur: *Arsimimi i kërkuar: Diplomë e studimeve universitare, Fakulteti Ekonomik, Juridik, Teknik me të paktën 240m kredi apo ekuivalente me to; Përvoja e punës e kërkuar: së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të cilat rregullojnë procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, gjegjësisht nenit 38 të këtij ligji me të cilin është përcaktuar se: *“1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni”. ...5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm .*

Po ashtu, Kolegji ka analizuar edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht: Nenin 44 më të cilin është përcaktuar se: *“1.Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidateve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje 3.Dispozitat, për procedurën e pranimin në shërbimin civil, të kësaj Rregulloreje, do të zbatohen*

përshtatshëmrisht edhe për procedurën e konkurimit për lëvizjen brenda kategorisë, për atë që nuk përcaktohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të kësaj rregullore”, nenin 47 me të cilin përcaktohet se: “1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pikë”, nenin 48 me të cilin përcaktohet se: “...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbledhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbledhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurrimit”, si dhe nenin 49 me të cilin përcaktohet se: “1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurrimi. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues”.

Duke u bazuar në dispozitat si me lartë, e në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit konstaton së mos publikimi i rezultatit të intervistës me gojë për arsye të Kryesuesja e Komisionit të Vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë nuk ka pas njohuri lidhur me procesin e vlerësimit, nuk përben shkak ligjor lidhur me mos vazhdimin e kësaj procedure, andaj, mbi bazën e këtyre fakteve dhe duke qenë së ankuesi me asnjë shkresë nuk ishte njoftuar me rezultatin e intervistës dhe ecurinë e procesit, Kolegji i Këshillit vlerëson së Komisioni i Vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë ka vepruar në kundërshtim me nenin 44 paragrafi 3 lidhur me nenin 25 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin është përcaktuar se: Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj”, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore ka vepruar në kundërshtim me parimin e informimit sipas nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 25 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin është përcaktuar se: “4.Në çdo rast, Njësia Përgjegjëse njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatin e detajuar të vlerësimit të kandidatit në çdo hap të vlerësimit.”

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 97 paragrafi 2 të këtij ligji me të cilin është përcaktuar se: “... 2.Përfundimi i një procedure administrative të nisur sipas detyrës zyrtare është në diskrecionin e organit publik, përpos kur parashihet ndryshe me ligj dhe bëhet me akt administrativ, dhe si rrjedhojë konstatoi së Komisioni i Vlerësimit me rastin e përfundimit të procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, duhet të nxjerr akt përfundimtar i cili duhet të përmbaj të gjitha elementet e aktit administrativ të përcaktuara me nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, meqenëse është konstatuar së procedura e vlerësimit të intervistës me gojë lidhur me




konkursin me nume reference RN00009710 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve" në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është përcjell me shkelje ligjore, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil si dhe nenin 53 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që të aprovohet si e bazuar ankesa e ankuesit dhe të obligohet Komisioni i Vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë, që të përfundoj procesin e vlerësimit lidhur me pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për Sigurinë e Produkteve, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, duke marr parasysh te gjeturat dhe pikëpamjet juridikë sipas këtij vendimi, rrjedhimisht me detyrimin që Komisioni i Vlerësimit të veproj në pajtim të plot me nenin 48 dhe 49 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1033/2022

Çlirim Zeka

Procesmbajtës


Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.